



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE  
Ndermarrja Prodhimit Çeliqueve Elbasan

Adresa : Ish Kombinati Metalurgjik Bradashesh Elbasan Tel & Fax. 058326076

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan me 02.05.2023

Proces – Verbal

Nr. \_\_\_\_\_, date 02.05.2023

Për miratimin e paketës së dokumentave të procedurës së prokurimit me objekt  
“*Blerje Karburant Gazoil D1 2023 per Ndermarrjen e Prodhimit te Çeliqueve Elbasan*”

I mbajtur sot më datë **02.05.2023**, në ambjentet e zyrave të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve, në prani të njësisë së prokurimit të krijuar me urdherin e Drejtorit të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve Elbasan, **Nr.150, dt. 05.04.2023**, për prokurimin e objektit “*Blerje Karburant Gazoil D1 2023 për Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve Elbasan*”.

Për prokurimin e këtij objekti është vënë në dispozicion fondi **1.478.400 (njemilion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind) lekë pa tvsh, ose 1.774.080 (njemilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë) leke me tvsh**, nga te ardhurat e Ndërmarrjes.

**Fondi limit është vlerësuar nga një komision i posacëm, i cili ka hartuar preventivin me zera, sasi dhe çmime** (shiko bashkëngjitur relacionin dhe preventivin e hartuar nga komisioni i posacem, si dhe regjistrin e parashikimit të prokurimeve).

**Ky fond është brënda parashikimit buxhetor që është miratuar për Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve për këtë zë shpenzimesh.**

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë “**E Hapur e Thjeshtuar**” (MALLRA).

Arsyet e përdorimit të procedurës së prokurimit: **Autoriteti Kontraktor prokuron mallra, me një vlerë nën kufirin e ulët monetar** (neni 34 i Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar, neni 40).

Procedura që do të përdoret është **Prokurim në Forme Elektronike**.

Njesia e prokurimit harton dhe miraton paketën e dokumentave të tenderit, në përputhje me modelet e dokumentave standarte të miratuara nga APP. Nga njesia e prokurimit, për hartimin e dokumentave të tenderit, merren për bazë dokumentat standarte të tenderit për **DST - Procedurën E Hapur Të Thjeshtuar - Mallra**, të miratuara nga APP dhe të publikuara të ndryshuara sipas vendimit **Nr. 03 Datë 09.06.2021** të APP. Keto dokumenta janë shkarkuar në rrugë elektronike (doëload), nga faqja zyrtare e APP: [website – www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Njesia e prokurimit harton dhe miraton Formularin e Njoftimit të Kontrates (kopje e përmbledhur), e cila do të dërgohet për botim në rrugë elektronike, në Buletinin e Njoftimeve Publike të APP-se, me datë **02.05.2023**, për tu botuar në sistemin elektronik me datë **03.05.2023**, si dhe në buletinin e ditës së hënë - datë **08.05.2023**, në mbështetje të kërkesave të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave: Data: 15/05/2023 Ora: 09:00.**

**Vendi i dorezimit te ofertave:** ne forme elektronike: eëbsite – eëë.app.gov.al.

**Afati kohor për hapjen e ofertave:** Data: **15/05/2023 Ora: 09:00**. (minimalisht kerkohen 10 dite nga shpallja e njoftimit te kontrates ne sistemin elektronik – LPP, neni 43, pika 7 dhe 8 – nderkohe nga data **03.05.2023** deri me **15.05.2023** respektohet afati 10 ditor).

Njesia e prokurimit harton dhe miraton **Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:**

## **OFERTA EKONOMIKISHT ME E FAVORSHME BAZUAR NE CMIM.**

Njesia e prokurimit harton dhe miraton paketen e dokumentave te tenderit, si me poshte:

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me permbajtjen e LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);
- b. Formulari i sigurimit të ofertës sipas Shtojcës 3.
- c. Formulari Permbledhës i Vetedeklarimit sipas Shtojcës 8
- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përgjithshme.

### 2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar :

**Lidhur me gjendjen ekonomike e financiare, kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat minimale:**

Vlerësimi i gjendjes ekonomike e financiare të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat dhe dokumentat e mëposhtme:

- 2.2.1. Vërtetim se i ka paguar taksat vendore për vitin 2022, leshuar nga njesia e qeverisjes vendore (Bashkia/Njesia Administrative) ku rezulton se ka seline sipas vërtetimit të QKR.
- 2.2.2. Xhiroja e tre viteve të fundit duhet të ketë një vlerë sa vlera e fondit limit.
- 2.2.3. Çertifikatë elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave ose çertifikatë elektronike për fiskalizimin dhe kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me shoqërinë e çertifikuar për zgjidhjen softërore-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softërore-ike.
- 2.2.4. Bilancet e viteve 2019, 2020 dhe 2021.
- 2.2.5. Certifikatë Cilesie ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015.
- 2.2.6. Raport Analize nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) brenda javës së parë muaji Prill 2023.
- 2.2.7. Vërtetim që nuk ka penalitete për cilësinë e mallit për vitin 2022.

### 2.3 Për kapacitetin teknik:

- a. License/Leje për tregtimin e karburanteve të leshuar nga Ministria përkatëse ose Autorizim për tregtimin e karburanteve të leshuar nga Njesite e Qeverisjes Vendore (**organet shtetërore kompetente përkatëse**).
- b. **Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: Kontrata të ngjashme sipas objektivit të prokurimit, të realizuara në tre vitet e fundit, me një vlerë 40% e fondit limit të prokurimit. Për këtë duhet të paraqitet:**
  - Dokumenti i Kontrates për furnizimin e ngjashëm, shoqëruar me Vërtetim nga autoriteti kontraktor, ku të specifikohet sasia dhe vlera përkatëse e furnizuar,
  - OSE
  - Dokumenti i Faturave Tatimore (me tvsh) të deklaruara për furnizimin e ngjashëm, ku të specifikohet sasia dhe vlera përkatëse e furnizuar (fature tatimore + libri i shitjeve).

- c. **Leje Mjedisore Tipi B.**
- d. **Policë Sigurimi**
- e. **Vërtetmm Teknik/Akt Teknik nga IMNZH**
- h. **Operatori duhet te kete pike shperndarje te karburantit ne pronesi ose marreveshje me ndonje pike shperndarje brenda territorit te Bashkise Elbasan dhe rrethinave perreth saj ne nje distance jo me te madhe se 5 (pese) km nga qendra e qytetit.**

*Kjo kerkese vendoset me qellimin per te mos shkaktuar konsum te tepert karburanti te panevojshem. Ne kushtet kur automjetet duhet te jene shume operative dhe te bejne levizje te shpeshta dhe ne shumicen e raste te paplanifikuara, nevojitet qe pika e furnizimit (mekanizmi i mbushjes me karburant) te jete sa me afer selise se autoritetit kontraktor, ose pikes ku qendrojne automjetet. Prandaj gjykohet qe pika e shperndarjes se karburantit, ne pronesi, apo ne perdorim te operatorit ekonomik kontraktues, te jete minimalisht 5 km nga qendra e qytetit, pra jo me larg sesa periferia e qytetit Elbasan, ku mbaron zona urbane dhe fillon zona rurale. Ne kete menyre automjetet do te furnizohen shpesh nuk do te kene konsum te tepert te panevojshem te karburantit. Keshtu do te rritet eficenca e konsumit te karburantit nga automjetet e Ndermarrjes se Prodhimit te Çeliqueve Elbasan. Nese operatori ekonomik do te kete marreveshjes per perdorimin e pikes se karburantit (pra jo ne pronesi), kjo marreveshje duhet te kete specifikuar adresen e sakte te pikes se shperndarjes se karburantit.*

- i. **Grafiku i Lëvrimit, e miratuar nga operatori ekonomik (e firmosur dhe e vulosur).**
- k. **Bazuar ne VKM Nr. 561, datë 29.7.2016 "Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", furnizimi me karburant për mjetet efektive të transportit të kryhet vetëm nëpërmjet kartës elektronike me të cilën mundësohen identifikimi i mjetit dhe përdoruesi i saj. Per kete operatori ofertues do te paraqese dokumentacion se disponon pajisjet per ofrimin e ketij sherbimi.**

*Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

**Njesia e Prokurimit perfshin ne dokumentat e tenderit Specifikimet Teknike, sikurse ato jane hartuar nga komisioni i posaçem.**

**Afati per levrimin e mallit: Levrimi i mallit do te behet me karte elektronike. Levrimi i mallit do te behet nga momenti i lidhjes se kontrates deri me 31.12.2023, sipas kerkeses se autoritetit kontraktor per karburant ne çdo moment, brenda kesaj periudhe. Kartat elektronike do te jene te perdorshme ne çdo moment te dites, ne çdo dite te javes.**

**Njesia e prokurimit e miraton paketen e dokumentave te tenderit, duke vleresuar:**

- Dokumentat e tenderit jane te rregullta, konform kerkesave te VKM nr. 285 dt. 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, kreu "Dokumentat e tenderit";
- Përputhen me modelet e miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, per objektin "MALLRA" – "Procedurë e Hapur e Thjeshtuar";
- Nuk jane diskriminuese, pasi kerkesat financiare dhe teknike jane minimale dhe te domosdoshme per realizimin e levrimit te mallit objekt prokurimi efektivisht;

- Jane te mjaftueshme per te orientuar operoret ekonomik qe do t'i terheqin per pergatitjen e ofertave te tyre ne perputhje te plote me kerkesat dhe kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor - **Ndermarrjes se Prodhimit te Çelikeve Elbasan.**

### **Disponimi i Dokumentave te tenderit.**

Dokumentat e tenderit do te jene te disponueshme (pa pagesë) pas hedhjes se tyre ne sistem, nga njesia e prokurimit dhe mund te terhiqen ne çdo kohe nga operoret ekonomike (pas publikimit te njoftimit te kontrates ne buletin), ne rruge elektronike, ne ëësite – ëëë.app.gov.al.

Pasi lexohet, proces-verbali dhe cdo faqe e paketes se dokumentave te tenderit bashkengjitur firmosen nga te gjithë anetaret e njesise se prokurimit.

### **Njesia e Prokurimit**

- |                 |  |
|-----------------|--|
| - Ardit KASA    | (Inxhinier)  |
| - Rin ARAPI     | (Specialist)                                       |
| - Erind NANUSHI | (Jurist i Jashtem – Person i autorizuar ne Sistem) |